



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Plani strategjik i kolegjit biznesi 2021-2024 në Kolegjin BIZNESI Prishtinë është hartuar në mbështetje të Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, në Statutin e Kolegjit neni 81 si dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, të Kolegjit BIZNESI, me datë 25.09.2020, miraton këtë:

PLANI STRATEGJIK I KOLEGJIT BIZNESI 2021-2024

Përmbajtja

Hyrje	3
Konteksti i zgjeruar i zhvillimeve të deritashme.....	4
Vleresimi i gjendjes	5
1.Menaxhimi dhe administrata.....	6
1.1.Decentralizimi i shërbimeve ne kolegji.....	6
1.2.Digjitalizimi i administrates:.....	6
1.3.Avancimet instituciale	6
2.Sigurimi i cilesise (SC)	7
2.1.Korniza per sigurimin e cilësisë.....	7
3.Sherbimet studentore	8
4.Mësimdhënia dhe kerkimi shkencor	8
5.Infrastruktura dhe teknologjia.....	9
6.Bashkepunimi ndërkombëtar	10
Aspektet kryesore te Planit 2021-2024	10
Misioni	10
Vizioni	10
Objektivat strategjike(OS)	11
Pershkrimi i masave sipas objektivave strategjike.....	11
OS 1. Thelimi i Institucioneve te reja	12
O.S.2. Te vendoset nje menaxhim dhe administrate efikase ne mbeshtetje te proceseve akademike e hulumtuese	15
O.S.3. Te ofrohen sherbime per perkrahjen e studenteve qe sigurojne kushte optimale te punes dhe studimit per permiresim e performances.....	16
O.S.4. Avancimi dhe fusha kerkimore shkencore si dhe digjitalizimi i shërbimeve	18
O.S.5. Bashkepunimi dhe partneritetet	19
Strategjia e komunikimit.....	21

Hyrje

Pas zbatimit me sukses te Planit per Zhvillimin e Kolegjit Biznesi 2014-2020 , Bordi dhe Dekanati Kolegjit Biznesi kanë vendosur të bejnë rishikimin e zbatimit të planit paraprak dhe hartimin e Planit Strategjik Zhvillimor të Kolegjit Biznesi 2021-2024. Për këtë qellim është emëruar ekipi i punës që do të koordinojë procesin e hartimit të Planit, si dhe ekipin e gjerë (që mbulon fushat kryesore te planifikimit duke përfshirë edhe partneret tanë të jashtëm), që do të kontribuojë duke marrë pjesë në punëtoritë e planifikimit.

Ekipi strategjik ka mbajtur mbledhje të rregullta mujore gjatë tërë procesit të planifikimit, ndërsa grupi i gjerë i përbërë nga partnerët tanë të jashtëm ka marre pjese ne tre punëtori planifikuese. Buxhetimi i aktiviteteve dhe plani i veprimit janë hartuar nga një grup i ngushtë punues i përbër nga Kolegji Biznesi.

Grupi punues për hartimin e planit strategjik 2021-2024

- 1.Dr Afrim Alili
- 2.Dr Besim Kelmendi
- 3.Dr Milazim Shabani
- 4.Dr Vehbi Imeri
- 5.Dr Mustaf Kadriaj

Plani Zhvillimor 2016-2020

Rishikimi i Planit te mehershem 2016-2020 , ka treguar se shumica e objektivave dhe masave të parapara janë arritur plotësisht . Jane bërë investimet në infrastrukture, teknologji, mjete të transportit, në punesimin e personelit mësimdheneës (per shkak te ndryshimit te kritereve nga ana e Agjencioni për Akreditim).

Programet e akredituara dhe riakreditimi janë interesim kolegjit po sikur si edhe zgjerimi me programe te reja.

Në këtë periudhë kohore Kolegji Biznesi ka investuar ne kapacitetet infrastrukture , teknologjike ne Qender dhe degën e saj ne Prizren .Kolegji me mundësit e saj zhvillimore ka vazhduar të avancoj zhvillimin e fushave të hulumtimit shkencor. Nje fushë tjetër që ka shënuar progres Kolegji Biznesi është avancimi në fushën e sigurimit të cilësisë.Ky planë është përmbushur plotësisht nga Kolegji Bznesi.

Më tutuje konkluzioni: Analizat e brendshme dhe fakotët e jashtë të analizuar për gjtaë kësaj periudhe kanë treguar se duhet përkushtim në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike.Pas një analize të thellë është themeluar Grupi Strategjitek ne udheheqje te Rekorit Prof.Dr.Shyqëri Kabashi. Në vazhdim po japim pasqyrën e zhvillimeve dhe të dhenave si dhe angazhimet e Kolegjit Bznesi të nxjerra nga objektivat strategjitke të propozuara nga Grupi Strategjik.

Konteksti i zgjeruar i zhvillimeve të deritashme

Pas dy dekadave të përpjekjeve për rindërtim të sistemit të arsimit të lartë, arsimit kosovar po hyn në një fazë të zhvillimit më të avancuar po sikur edhe Kolegji Biznesi.

Krahas avancimit të deritshëm janë paraqitur rrethana të reja dhe zhvillime tjera sociale, ekonomike dhe shoqërore, që shtojnë nevojën për një zhvillim më të madh. Këto vite ishin vite të progresit të edukimit dhe ofrimit të dijës.

Këtë periudhë e karakterizojnë rritja e interesimit për edukim superior, interesimi për edukim sipas statistikave tona janë 65 studente për 1000 banorë.

Kosova në këtë periudhë arriti të tejkalojë për nga interesimi për studime superiore edhe vendet rajonale.

Pos aspekteve pozitive kjo periudhë shënoi një fokusim të shtuar kryesisht në fitimin e diplomave dhe kualifikimeve universitare kryesisht në shkencat shoqërore, e në veçanti ato ekonomike, drejtesi si dhe fushën tjetër të emergjencave. Sipas të dhënave tona interesimi i studentëve të rinj për të studiuar në Kolegjin tonë ishte impresionues.

Në këtë periudhë Kohë Kolegji Biznesi është angazhuar në ofrimin e mundësive të favorshme për studime më të avancuar konform zhvillimeve të ekonomisë së tregut, duke respektuar më së miri interesin e studentëve të rinj.

Trendet e zhvillimit të ekonomisë së tregut janë tregues për interesimin e maturantëve të po sa diplomuar në shkollat të mesme në përcaktimin e tyre për fushën e studimeve. Ofrimi i shërbimeve cilësore në edukim lidhën drejtpërdrejt me nevojat për punësim që është interesi themelor i të rinjve në këtë periudhë dinamike të zhvillimit të ekonomisë.

Pak ka ndikim cilësia e shërbimeve të ofruara në institucionin e arsimit të lartë nëse studenti nuk është i motivuar për të studiuar, duke pasqyruar këtë fakt Kolegji Biznesi e ka shtuar nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes angazhimit shtesë të kapaciteteve të Kolegjit sic është rritja e orëve praktike në fushat e programeve të studimeve përkatëse si dhe inkurajimi i studentëve të mësojnë gjuhët e huaja atë angleze dhe gjermane, duke krijuar mundësi më të mëdha të mësimnxënies për të gjithë studentet.

Rritja e cilësisë është imponuar për këtë arsye ishte e nevojshme mobilizimi në këtë drejtim i të gjitha kapaciteteve profesionale të Kolegjit.

Gjendja e tillë e ka vendë Kolegjin Biznesi para sfidave thelbësore: duke u gjendur në mes të misionit të vet për arsim cilësor dhe konkurrencës së madhe nga institucionet e tjera.

Dhe sfida tjetër e madhe për Kolegjin Biznesi ka qenë trajtimi jo i barabartë i institucioneve private nga autoritetet arsimore publike në Kosovë, edhe pse kjo qasje po vjen duke u përmirësuar.

Kolegji Biznesi është i interesuar për një trajtim të barabartë të të gjithë sektorve të arsimit të lartë që konsiderojmë se duhet të ndodhë një qasje më e avancuar nga institucionet e shtetit.

Pra qasja e barabartë e vlerave duhet të mbizotroj në konkurrencë të lirë pa marr parasysh a është arsim publik apo privat.

Trajtimi i studentëve në mënyrë të barabartë do të thotë qasje me e mirë dhe me e drejt në punësim në sektorin e shërbimit civil , publik dhe sektorin privat.

Institucionet publike dhe private duhet të konkurrojnë me vlera programore dhe cilësi, por jo me dhënie përparësie institucioneve pa marr parasysh se kush është themelues i tyre shteti (publike) apo sektori private.

Pra qasja duhet të jetë e barabartë, konstruktive dhe të dominojë vlera ndaj antivlerës në fushën e përgatitjes shkencore apo punëimit.

Përkunder këtyre veshtiresive gjatë këtyre viteve Kolegji Biznesi ka shënuar një shkallë mesatare vjetore të zhvillimit prej rreth 15 %, në ndërtimin e kapaciteteve të mësimdhënies dhe ndërtimin e kapaciteteve infrastrukturore, gje që paraqet zhvillim domethënës për një institucion të arsimit të lartë në Kosovë dhe në rajon. Në këtë drejtim kemi një avancim të përgatitjes së kuadrove në fushën e emergjencave edhe për Kosovë por edhe Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Kolegji Biznesi ka bërë investimet në fushën e infrastrukturës duke plotësuar nevojat e brendshme. Kolegji Biznesi është një nga institucionet konkurruese në fushën e edukimit të lartësë bashku me kolegjet tjera dhe Universitetet Publike .

Kolegji Biznesi tash më ka siguruar mbi 90 % të personelit të perhershëm të kualifikuar sipas kërkesave rigoroze të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Kolegji ka bërë digjitalizimin e proceseve akademike dhe atyre administrative me aplikacione origjinale të programimit aktualë.

Kolegji Biznesi në kuadër të strategjive ka zhvilluar edhe sferën e punëimit të studentëve të saj në sektorin privat, duke hartuar marrëveshje për trajnim dhe punësim me shumë kompani në sektorin private më gjerë.

Ekipi i planifikimit strategjik i Kolegjit Biznesi ka identifikuar fushat e intervenimit si në vijim:

1. Menaxhimi dhe administrata
2. Sigurimi i cilësisë
3. Shërbimet studentore
4. Mesimdhënia dhe kërkimi shkencor
5. Infrastruktura dhe teknologjia
6. Bashkëpunimi dhe partneriteti në çështjet e nderlidhura: Inovacioni dhe sektorin privat.

Vlerësimi i gjendjes

Siç është thënë më lartë Kolegji Biznesi në katër vitet e fundit ka kaluar nëpër procese jashtëzakonisht dinamike zhvillimore dhe po ashtu shumë sfidauese që e kanë përballur personelin rreth saj me sfida të shumta por edhe me rezultate impesive, sic ka bërë Kolegji Biznesi të dallohet në zhvillimin e shkencave të emergjencave jo vetëm në vend por edhe në rajon.

Per analizen e gjendjes ekipi strategjik ka aplikuar instrumentin e analizes SWOT, me ç'rast jane analizuar perparësitë , dobësitë (brendshme), dhe mundësite dhe rreziqet që janë faktor i jashtëm, por që janë marr parasysh në ndërtimin e mundësive për t'i parandaluar ose zvogluar efektin e tyre potencialisht negativ (rreziqet).

Grupi i planifikimit strategjik ka bere analizen e gjendjes aktuale sipas fushave te intervenimit duke identifikuar aspekte (kryesisht perparësitë dhe dobësitë) te cilat pastaj janë shndërruar ne objektiva specifike zhvillimore.

Ne vijim pasqyrohen shkurtimisht aspektet kryesore te vleresimit te gjendjes nga grupet e planifikimit.

1.Menaxhimi dhe administrata

1.1.Decentralizimi i shërbimeve ne kolegji

Ne kete fushë Kolegji Biznesi ka percjellë zhvillimin e hovshem te administratës me ndryshime përkatëse në strukturen organizative dhe ne përmbajtjen e shërbimeve administrative. Fillimisht jane bërë ndryshime ne strukturen e organizimit te adoptuar të kolegjit prej programeve studimore ne fakultete.

Për këtë arsye, por edhe per shkak te rritjes se numrit te studenteve, Kolegji Biznesi ka realizuar nje delegim dhe decentralizim te pergjegjesive te shumta prej dekanatit ne pergjegjes të programeve. Pergjegjësit e programeve kane marre me shume pergjegjesi ne perzgjedhjen dhe menaxhimin e personelit, si dhe ne menaxhimin e resurseve materiale e financiare.

Tash me është shtuar numri i shërbimeve administrative qe jane kryer ne nivel te pergjegjëseve përkatës ,perfshire transferet, mbikeqyrjen e punes praktike, menaxhimin e cilesise, projektet studentore e te tjera.

1.2.Digjitalizimi i administrates:

Gjate kësaj periudhe janë digjitalizuar të gjithë shërbimet e administrates, perfshire e-Menaxhimin (planifikimi dhe raportimi), e-Ceritfkata (nxjerrja e certifikatave), evidentimi i rregullsise se mesimit (sistemi elektronik i evidentimit), menaxhimi i komunikimit ne relacionin mesimdhënes –student(eProfesori-kontakti online), konsultimi elektronik i mesimdhënësve me studentet, sistemi i pagave (bazuar ne evidentimin elektronik), e shume te tjera.

Te gjitha këto kane qene zgjidhje origjinale te disenjuara nga ekipet e programuese të Kolegjit Biznesi ne kuader te sektorit te administrates. Keto zgjidhje kane mundësuar lirimimin e personelit nga pune rutinore ne aktivitete te tjera qe kanë ndihmuar me shumë performancen e studenteve.

1.3.Avancimet instituciale

Sfidave te kohes dhe trendeve ne fushen e arsimit ne Kosove Kolegji Biznesi i është pergjigjur me fleksibilitet institucional dhe me diversifikimin e ofertes arsimore.

Ne kuader të kësaj qasjeje **Instituti për Emergjencë dhe Hulumtime** ka zhvilluar programe adekuate në fushën e trajnimit të stafit të kompanive publike dhe private me fushën e sigurisë në punë dhe dhënien e përgjigjeve adekuate në situatat e caktuara- termete, vërshime dhe mbrojtja nga zjarri.

Po ashtu në kuadër të Kolegjit është themeluar njësi për hulumtim elektronik-qasja në biblioteka vendore dhe ndërkombëtare. Fusha e menaxhimit është përcjellë edhe me sfida të shumta që lidheshin kryesisht me rritjen e shpejte të institucionit dhe të numrit të studenteve.

Ndër mundësitë që janë përmendur janë imazhi pozitiv i ndertuar nga Kolegji Biznesi gjatë viteve, pastaj rregullimi me i mire i kornizës ligjore, zhvillimin e transparencës në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës, rritja e interesimit të studentëve për të përfituar nga mundësitë e ofruara për studim, e të tjera.

Njëkohësisht, grupet punuese kanë identifikuar edhe rreziqe të shumta që kanë vazhduar të vijnë nga rrethi dhe konteksti me i gjerë në Kosovë siç është trendi i përshpejtuar i nevojave për tregun vendor.

2.Sigurimi i cilësisë (SC)

2.1.Korniza për sigurimin e cilësisë

Korniza e re për sigurimin e cilësisë mund të jetë një prej arritjeve më të mëdha të Kolegjit Biznesi në periudhën e zbatimit të Planit të kaluar zhvillimor.

Zyra për Cilësi ka arritur që saktësisht të përmbushë përgjegjësitë dhe detyrat e menaxhmentit të mesimdhënësve në procesin e SC-se.

Jane zhvilluar formularet përkatës për të gjitha aspektet e SC-se (përfshirë vlerësimin e studenteve dhe të mesimdhënësve individualisht, pastaj zhvillimin e kurrikulave, përkrahjen e akreditimit, kontributi i dhënë për raportin e vetëvlerësimit dhe të tjera).

Më tutje janë digjitalizuar proceset kryesore të sigurimit të cilësisë (për shembull vlerësimi i mesimdhënësve nga studentet), janë vendosur dhe implementuar procedurat për monitorimin dhe përkrahjen e personelit mesimdhënës/

Te gjitha këto aktivitete që janë ndërmar janë bazë efektive për zhvillimin e mëtejshëm të cilësisë në Kolegjin Biznesi në intervenimet strategjike të periudhës së mbuluar nga ky plan.

Sigurimi dhe zhvillimi i personelit:

Njëkohësisht Kolegji Biznesi ka investuar shumë në sigurimin e personelit të kualifikuar (sipas kërkesave strikte në pajtim me AKK), dhe në zhvillimin akademik dhe profesional të personelit mesimdhënës. Në këtë kontekst, Kolegji Biznesi ka arritur të ketë personel 98 % të kualifikuar sipas kërkesave të Agjencisë së Akreditimit dhe mbi 92 % të personelit mesimdhënës.

Zyra ka organizuar një sërë aktivitetsh (mbi dhjetë punëtorë) për zhvillimin profesional të personelit me trajnues vendor dhe ndërkombëtar.

Edhe kjo ka bërë që Kolegji Biznesi të pres me lehtësuar fazen e ardhshme të ngritjes së cilësive të mesimit dhe të hulumtimit shkencor në katër vitet e ardhshme.

Sfidat kryesore janë lidhur edhe me arritjet e shumta dhe me dinamizimin e proceseve nëpër të cilat ka kaluar Kolegji Biznesi në katër vitet e fundit.

Fillimisht ka pasur vështirësi në jetesimin e digjitalizimit të aspekteve të ndryshme të sigurimit të cilësive (për shembull publikimi i sylabuseve elektronike dhe ndertimi i vlerësimit të studenteve bazuar në keteqasje-tash me e aktivizuar); integrimi i personelit të ri mesimdhënës në kulturën dhe rutinën e punës në Kolegjin Biznesi pastaj angazhimi i personelit të kualifikuar për lëndet e reja mësimore në përputhje me trendet teknologjike, ekonomike e shoqërore;

Metodologjia e tejkaluar e punës të një pjese të personelit për shkak të mungesës së njohurive të mjaftueshme teknologjike tash më është tejkaluar plotësisht përmes organizimit të trajnimeve të reja; studentet kanë kapacitete të mjaftueshme në përdorimin e teknologjisë. Zyra po ashtu në të njëjtën kohë ka identifikuar edhe mundësi të ndryshme efektive për sigurimin e cilësive në Kolegjin Biznesi.

3.Sherbimet studentore

Kolegji Biznesi rregullisht bën vlerësimin e studenteve lidhur me shërbimet akademike e administrative që u ofrohen atyre. Rezultatet e këtyre vlerësimeve i shërbejnë Kolegjit Biznesi për avancimin e mëtej të këtyre shërbimeve dhe ofrimin e shërbimeve të reja duke iu përshtatur nevojave të tyre.

Pos këtyre mendimeve të studenteve, grupet e planifikimit identifikuan një sërë arritjesh të cilat kishin shërbyer për të përmirësuar jetën studentore në kolegji, administratën dhe performancën e tyre në studime.

Këtu përfshihen mundësia e qasjes në burime elektronike, sigurimi i transportit, perkrahja përmes orëve tutoriale, digjitalizimi i shërbimeve studentore, realizimi i projekteve hulumtuese me pjesëmarrje të studenteve, ofrimi i orëve plotësuese sipas nevojave të identifikuar në kurse të caktuara e të tjera. Nder dobesitë e identifikuar si nga vlerësimet e studenteve dhe në seancat e planifikimit u përfshinë: mungesa relative e literaturës e cila pritet të shtohet rreth 50% me literature në gjuhën angleze dhe gjuhë tjera, përshtatja e bibliotekës së re për rrethanat e reja që po vijnë, nxitjen e botimeve nga personeli arsimor dhe studentor si dhe bashkëpunimi në fushën hulumtuese profesor -student, kërkesa për studime praktik në punë në institucione publike dhe private. Mungesa relative e projekteve hulumtuese me përfshirje të studenteve, me shumë mundësi për punë praktike e të tjera. Nder mundësitë dhe kërkesat për avancim të shërbimeve studentore përfshihen me shumë aktivitete studentore në kampus dhe jashtë tij (punë në shtëpi), me shumë vizita studimore, shfrytëzimi më i mirë i mundësive që ofrohen nga objektet e reja, organizimi i me shumë projekteve studentore e të tjera. Të gjitha këto janë trajtuar në masat e propozuara të këtij Plani.

4.Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor

Në këto dy fusha thelbësore për secilin institucion të arsimit të lartë edhe për Kolegjin Biznesi ka rëndësi të madhe pra kolegji ka realizuar progres të konsiderueshëm gjatë periudhës së kaluar.

Ne fushen e shkences janë organizuar dymbdhjet (12) konferenca shkencore me karakter nacional dhe një me karakter nderkombëtar qofte nga personeli i Kolegji Biznesi -se ose ne bashkëpunim me institucione nga rajoni dhe me gjerë ; jane organizuar simpoziume tematike dhe debate me eksperte vendore, me zyrtare te larte nga vendi; janë ndihmuar me dhjetëra mësimdhenës qe te marrin pjesë në konferenca shkencore dhe të publikojnë punimet e tyre në revista shkencore; jane botuar me dhjetëra tituj libra, monografi (67-gjashtëdhjeteshtatë), e te tjera me përkrahje të Kolegjit

Kolegji Biznesi ka themeluar komisionin per dhënie të çmimeve shkencore për të arriturat e fundit në fushën e hulumtimit.

Jane publikuar çdo vit nga dy numra te revistes shkencore "BIZNESI" ku janë botuar me dhjetëra artikuj nga autoret e Kolegji Biznesi ose te jashtem.

Ne fushen e mesimdhënies është konsoliduar procesi i hartimit te kurrikulave, pastaj eshte avancuar metodologjia e punes me studente. Jane siguruar materiale dhe literatura per te gjitha kurset, është avancuar vleresimi i studentëve, dhe janë zhvilluar aspekte te tjera të rëndësishme qe e bejnë Kolegjin Bzinesi - te dallohet nga te gjitha institucionet e tjera ne Kosove e mbase edhe ne rajon.

Ne vitin 2017, Koelgji Biznesi per here të pare ka organizuar me sukses procesin e promovimit akademik te personelit te vet. Në këtë kuader 6 doktor shkencash jane avancuar ne thirrjen profesor asistent, dhe 8 profesor asistente jane avancuar në profesor te asocuar.

Këtë e kanë reflektuar edhe platformat e ndryshme Kolegjin Biznesi – te cilin e vendosin një ne nder institucionet me prani me të madhe në internet me më shumë punime shkencore të botuar në revista vendore dhe ndërkombëtare . Ne anën tjetër janë konstatuar edhe mangësi të cilat janë tejkalua.

Në këtë periudhë ka pas shumë interesim studentor për të ndërtuar një platformë te ciluar nga ne si Mësim-Punë Praktike-Punësim, duke pas parasysh kërkesën e studentëve Kolegji do të nis platformën 2020-2024.

5. Infrastruktura dhe teknologjia

Kolegji Biznesi gjatë periudhes se kaluar katër vjeçare ka berë investime ne procesin e arsimit hapësirat mesimore janë zgjeruar për me shume se 500m2 vetem ne kampusin e Prishtines dhe atë në Prizren.

Kolegji Bzinesi do te vazhdoje me investime ne infrastrukture per te percjelle rritjen institucionale si ne numer te studenteve ashtu edhe ne zgjerimin e ofertes arsimore (me programe te reja në peridudhën 2021-2024).

Njekohesisht, edhe perkunder investimeve te rendesishme qe jane bere ne furnizimin e objekteve me pajisje teknologjike, Kolegji Biznesi do të vazhdojë investimet ne kete drejtim per te mbajtur hapin me zhvillimin e hovshem te teknologjive te reja. Pos ketyre, gjate vleresimit te gjendjes

aktuale ne fushen e infrastruktures së bibliotekes pritet riorganizim i ri dhe furnizim me literature të re të bibliotekës.

6. Bashkepunimi ndërkombëtar

Ne fushen e bashkëpunimit ndërkombëtar kolegji Bzinesi është përballur me sfida të shumta, para se gjithash të jashtme, por edhe janë arritur suksese të konsiderueshme. Nder sfidat kryesore kane gene ngecjet ne integrimin e Kosoves dhe te arsimit te larte ne strukturat perkatese evropiane.

Per shkak te pamundësisë per t'u anetarësuar ne Keshillin e Evropes, Kosova nuk mund ta nenshkruaj as Deklaraten dhe t'i bashkohet plotësisht Procesit te Bolonjes dhe Hapesires Evropiane te Arsimit te Larte.

Ngecjet ne procesin e integrimiëve evropiane kane ndikuar edhe ne mundesine per perfitim nga fondet e programet e ndryshme evropiane dhe ne qarkullimin e lire te mesimdhënesve e studenteve në këtë hapsirë.

Nje status i tille ka bere qe Kolegji Biznesi te mos jetë ne gjendje te lidhe marreveshje bashkepunimi me institucionet elite evropiane.

Perkunder ketyre veshtiresive, Kolegji Bzinesi gjate periudhes se kaluar është dalluar nder institucionet kosovare te arsimit te lartë per nga numri i konferencave shkencore te karakterit ndërkombëtar sidomos në fushën e emergjencave.

Per fillimin e procesit te mobilitetit (shkembimeve) te personelite te studenteve me institucione cilesore evropiane te arsimit te larte Kolegji Biznesi ka nëshkruar marrëveshje me universitet Itali, Shqipëri , Maqedoni dhe Bullgari etj.).

Aspektet kryesore te Planit 2021-2024

Gjate procesit te planifikimit grupet punuese te caktuar nga Dekani kanë bere dy takime te grupit strategjik , tre takime te grupit te zgjeruar dhe dy takime te Keshillit të Lartë Mësimor per te diskutuar dhe riformuluar vizionin e misionin e Kolegjit, fushat e intervenimit, objektivat strategjike, masat dhe caqet e Planit Zhvillimor. Fillimisht, grupet punuese jane dakorduar lidhur me vizionin dhe misionin e organizates:

Misioni

Misioni i Kolegjit “BIZNESI”, ka për qëllim ofrimin e veprimtarive arsimore, shkencore, hulumtuese, përmes metodave moderne të mësimdhënies ne fushat e ekonomisë, juridikut dhe emergjencave ne ndërtimin e kapaciteteve humane për nevojat e ekonomisë së tregut ne vend dhe më gjerë.

Vizioni

Vizioni i Kolegjit “BIZNESI” – është ndërtimi i vlerave : shkencore, hulumtuese dhe inovacioneve , përmes të cilave do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, social dhe komunitetit të

vendit dhe promovimin e Kolegjit në gjithë hapësirën e Republikës së Kosovës, në vendet e rajonit dhe më gjerë.

Objektivat strategjike(OS)

Per sendertimin e vizionit dhe realizimin e misionit te vet, Kolegji Biznesi ka percaktuar nje sere objektivash strategjike per periudhen pesevjeçare ne vijim. Grupi per planifikim ka vendosur nga nje objektive strategjike per secilen fushe te intervenimit. Ne vijim jepen objektivat strategjike te ketij Plani zhvillimor:

- OS 1 Themelimi i institucioneve te reja si në vijim: themelohet Qendra e Kolegjit per Mesimdhënie Inovative (QKMI), Themelohet njësi për planifikim strategjik(afatë mesëm dhe afatë gjatë), Themelimi i njësis në zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar për aplikim në thirrjet për Erasmusen +

Masa: Nxjerrën vendime nga Këshilli Mësimor Shkencor i Lartë dhe nxjerrren rregulloret e punës për funksionalizimin e tyre.

OS 2. Te vendoset nje menaxhim dhe administrate efikase ne mbeshtetje te proceseve akademike e hulumtuese,

OS 3. Te sigurohen perkraheje e shtuar per procedura transparente dhe pjesemarrese te sigurimit te cilesise,

OS 4. Te ofrohen sherbime per perkrahejen e studenteve qe sigurojne kushte optimale tepunes ne sherbim te permiresimit te performances se studenteve,

OS 5. Te perkrahen projekte zhvillimore e hulumtuese te personelit e te studenteve ne funksion te ngritjes se relevances se studimeve,

OS 6. Te avancohen kushtet e punes dhe te vendoset nje kulture e shkelqyer , inovacionitdhe e perdorimit te teknologjive te reja ne funksion te zhvillimit te cilesise se sherbimeve arsimore e hulumtuese,

OS 7. Te avancohet bashkëpunimi me partnerë vendore e nderkombetare per te lehtesuar komunikimin dhe shkëmbimin e dijes, vlerave dhe arritjeve te personelit e te studenteve te Kolegjit Biznesi me institucione simotra ne vend dhe jashte.

Pershkrimi i masave sipas objektivave strategjike

Pas vendosjes se objektivave strategjike, grupi per planifikim ka identifikuar nje sere masash konkrete dhe aktivitetesh te cilat do te sherbejne per jetesimin e objektivave zhvillimore te Kolegjit Biznesi . Grupi per planifikim ka identifikuamasat te cilat jepen si nëvijim pershkrime te shkurta te strategjive permes te cilave synohet jetesimi i ketyre objektivave:

OS 1. Thelimi i Institucioneve te reja

1. Themelimi i institucioneve te reja si në vijim: themelohet Qendra e Kolegjit per Mesimdhënie Inovative (QKMI), që ka për qëllim zhvillimin e mendjes shkencore kreative që do të funksionoj si qendër edhe për personelin mësimdhënës edhe studentet. **Misioni:**

Qendra ofron shërbime të certifikuar të aftësimit dhe perkrahjes profesionale për personelin akademik dhe administrativ në Kolegjin dhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në funksion të ngritjes së cilësive të mesimdhënies dhe të studimeve. Qendra do të punësojë një koordinator me norme të plote dhe **lehtësues** me angazhim sipas programit të punës.

Qendra do të ketë këto tri komponenta kryesore:

a) Programet e aftësimit - përfshirë hartimin e udhëzuesve,

b) Keshillimi dhe mentorimi,

c) Teknologjia dhe materialet mesimore.

Programet dhe modulet e aftësimit do të ofrohen në tre forma:

-programi inovativ kreativ që ka të bëjë me hartimin e projekteve për të ardhmën që kontribuojn edhe për zhvillimin e Kolegjit Biznesi por edhe zhvillimin e lartë inovativ shkencore për adoptimin e rrethaneve që vijnë.

-programi për avancimin e personelit për nevojat e Kolegjit Biznesi ,

-programi për avancimin e personelit me qëllim të avancimit akademik

1.1. Themelohet njësi për planifikim strategjik (afatë mesëm dhe afatë gjatë), kjo njësi do të ofroj materiale zhvillimore edhe kahje të veprimit në të ardhmen për realizimin e misionit dhe vizionit të Kolegjit Biznesi.

1.2. Themelimi i njësis në zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar për aplikim në thirrjet për Erasmus +

1.3. Përforsimi i funksionimit të Zyrës për Cilësi (ZC), zgjerimi me stafë.

Masa :

Zyra për Cilësi do të ketë Zyrën Qëndrore të përbër nga 10 zyrtar dhe zyrqën mbështetëse të saj në Vushtrri prej 5 zyrtarve.

Zyra për Cilësi do të hartoj planin e saj strategjik 2020-2024. Themelohet grupi punues nga zyrtar të brendshëm dhe të jashtëm.

1.4 Te sigurohet perkrahje e shtuar për procedurë transparente dhe pjesëmarrëse të sigurimit të cilësisë

Masat:

1.4.1. Digjitalizohen elementet kryesore të procesit të mesimdhënies dhe të vlerësimit të studenteve

Njësia e Programimit (sektori i administratës), në bashkëpunim me Zyrën për Cilësi, punon për:

(a) vazhdimin e digjitalizimit të aspekteve të rëndësishme të procesit mesimor, përfshirë avancimin e publikimit të silabuseve (përfshirë edhe prezantimin e kurseve nëpërmjet të video-projektioneve), përmirësimin e përdorimit të teknologjisë për prezantime (në Power-point) , publikimin e literaturës, kontrollimin e arkivimit të detyrave dhe të rezultateve, komunikimin mesimdhënës-studente për qëllim në mesim. Për këtë qëllim do të bëhet vlerësimi i zbatimit të e-Profesorit gjatë dy viteve të para. Procesi i vlerësimit do të përfshijë idetë e të gjithë pjesëmarrësve

relevante, por edhe praktikat e mira ne institucione te tjera ne vend e jashte. Ne baze te rekomandimeve te vleresimit dote behen edhe intervenimet e duhura ne sistem.

b) fillimin e zbatimit te digjitalizimit te nje pjese te vleresimit te studenteve nepermjet te testeve online.

Testimi online nuk do te zevendesojë ose eliminojë format e testimit me pyetje te hapura, seminaret, projektet, esejat, e te tjera. Qellimi i kesaj forme eshte lehtësimit dhe dinamizimi i procesit te vleresimit te studenteve, rrjedhimisht edhe te procesit mesimor. Testimi online do te pilotohet fillimisht ne nje numer te lendeve për studentet ne distancë, per t'u finalizuar ne baze te gjetjeve te vleresimit te pilotit.

3.3. Hartohen dhe akreditoen programe te reja atraktive arsimore dhe aftesuese.

Kolegji Biznesi do te perdor rezultatet e studimeve te tregut te kryera nga institucione publike dhe te pavarura, si dhe do te kryeje vleresime te nevojave te tregut me ekspertet e vet, per te vendosur se cilat programe te reja do te hartohen.

Rezultatet e ketyre studimeve mund te sherbejne edhe per pushimin ose modifikimin e programeve ne fusha te caktuara (nese nuk ka interesim ose nuk verehet perspektive e qarte per te diplomuarit). Gjate periudhes se zbatimit te ketij Plani Kolegji Biznesi do te perqendrohet edhe ne programe per certificate dhe ne programe multidisiplinore. Pos kesaj, drejtimet e Kolegjit Biznesi rregullisht do te perditesojne se paku 15 % te permbajtjes te gjitha kurseve te akredituara per te percjelle trendin e avancimit te dijes.

1.4.2 Dizajnohen, akreditoen dhe zbatohen programe online te studimeve qe synojne studente nga diaspora dhe nga vende te tjera.

Caku:Kolegji Biznesi do te disenjoje/ hartoje dhe do te akreditoje programe online te studimeve te cilat do te perdoren qofte per implementim e mesimit te kombinuar ose per format e te nxenit të mësimi elektronik. Kjo forme e mesimit do te sherbeje edhe per te lehtësuar perfshirjen e studenteve shqiptare nga diaspora dhe te studenteve te huaj qe do te studiojne ne Kolegji Biznesi ne te ardhmen.

Programi do te disenjohet nga njesia perprogramim ne bashkepunim me ekspertet e Kolegjit Biznesi per fushat e perzgjedhura.Se paku nje program i studimit online eshte ne dispozicion deri ne fund te vitit.

1.4.2 Forcohet komponenta e punes praktike:

